



Instituti i Kërkimeve Urbane

**VLERËSIMI I PËRFITUESVE I PROGRAMIT TË PUNËS SË
BANKËS BOTËRORE, I MENAXHUAR NGA FONDI SHQIPËTAR
I ZHVILLIMIT.**

Qëllimi kryesorë është zhvillimi dhe zbatimi i një metodologjie për vlerësimin e përfituesve në zonën e zbatimit të projekteve të infrastrukturës të financuara nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit nën financimin e Bankës Botërore. Vlerësimi u zhvillua përmes kombinimit të disa metodologjive përfshirë sondazhin, grupet e fokusit me komunitetin përfitues dhe intervista me zyrtarë të zgjedhur lokalë dhe agjencitë e qeverisë qendrore.

Anketimi përfshiu një mostër prej 1,200 zyrtarë të qeverisë vendore dhe qendrore, përfaqësues të komunitetit, kompani private ndërtimore dhe zyra private projektuese, të shpërndara në 22 njësi të qeverisjes vendore përfituese të 42 nënprojekteve infrastrukturore. URI ishte përgjegjës për të hartuar instrumentin e anketimit, për të kryer operacione në terren, për administrimin e të dhënave si dhe raportimin e gjetjeve. Gjithashtu organizimin dhe ofrimin e një Konference Kombëtare e cila u mbajt në Tiranë në Qershor të vitit 2002 për të publikuar gjetjet kryesore të aktivitetit të vlerësimit të përfituesve.